



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE

VENDIM

Nr. 41, Dt. 06.08.2007

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit uJOR, lumi Vjose, per prodhim te energjise elektrike, ne HEC-in e "Carshoves" subjektit "Tekno Projekt" sh.p.k. Tirane.

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-ve nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit uJOR, lumi Vjose, ne afersi te fshatit Carshove, (rreth 100 m poshte vend derdhjes te perroit te Carshoves ne lumin Vjose), per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Tekno Projekt" sh.p.k. Tirane.
2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete (prurja e gjithe lumit) $Q_{mes} = 55 \text{ m}^3/\text{sek}$.
3. Kuota e marrjes te ujit (aksi i Carshoves), ne afersi te fshatit Carshove (rreth 100 m poshte tij), me koordinata:
 $X = 44 \ 60 \ 280 \quad Y = 44 \ 42 \ 300 \quad Z = 330 \text{ m}$
4. Periudha e shfrytezimit te ujit, gjate gjithe vitit, (nga 1 janari deri me 31 dhjetor).
5. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
6. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

VeZir METAJ



KRYETARE E K.B.U-se

Dorothe KONOMI

